

Tiranë më 28.12.2023

KËRKESË

Drejtuar: Kryetarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Objekti: Kërkohen, Kopje të procesverbalit dhe audios dhe të transkripteve të seancave të datave 26 Dhjetor 2023 ora 10:00 dhe 27 Dhjetor 2023 ora 11:00;

Vendimin e Arsytuar për papranueshmërinë e kërkesë për përjashtimin e gjyqtares Irena Gjoka depozituar nga ana jonë në datën 26 Dhjetor 2023, një kopje të dosjes ku përfshihet edhe mendimi i gjyqtares Irena Gjoka, si dhe aktet administrative/gadishmërinë se si është caktuar gjyqtarja Rudina Palloi për gjykimin e kësaj kërkesë;

Vendimin e Arsytuar për papranueshmërinë e kërkesë për përjashtimin e gjyqtares Irena Gjoka bërë në seancën e datës 24 Tetor 2023 dhe depozituar nga ana jonë në datën 25 Tetor 2023, një kopje të dosjes ku përfshihet edhe mendimi i gjyqtares Irena Gjoka, si dhe aktet administrative/gadishmërinë se si është caktuar gjyqtarja Rudina Palloi për gjykimin e kësaj kërkesë.

Baza ligjore: Nenet 105, 115, 116 dhe neni 6 të K.Pr.Penale

E nderuar znj. Kryetare!

Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është duke u shqyrtuar, kërkesa për zëvendësimin e masave “Detyrim për t’ u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” me masën e kërkuar nga prokuroria “Arrest në shtëpi” ndaj personit nën hetim Sali Berisha, në kuadër të procedimit penal nr. 287/2020.

Ne mbrojtësit me prokurë kemi të nevojshme një kopje të procesverbalit dhe audios dhe të transkripteve të seancave të datave 26 Dhjetor 2023 ora 10:00 dhe 27 Dhjetor 2023 ora 11:00.




Në nenin 115 të K.Pr.Penale parashikohet se “1. Kur është e mundur, aktet e kryera gjatë seancës gjyqësore, si dhe çdo akt tjetër i kryer jashtë saj, dokumentohen nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv. Regjistrimi fillon dhe mbaron në të njëjtën kohë me seancën gjyqësore.” Ndërkohë në pikën 9 dhe 10 të nenit 115 të K.Pr.Penale parashikohet se: “9. Kur mbahet me regjistrim audio ose audioviziv, regjistrimi ruhet në programin elektronik përkatës për aq kohë sa ruhet dosja gjyqësore. 10. **Palët kanë të drejtë në çdo kohë të marrin kopje të regjistrimit dhe procesverbalit të mbajtur me shtypshkrim apo dorëshkrim, kundrejt tarifave përkatëse.**”

Gjithashtu në nenin 116 të K.Pr.Penale (Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive) parashikohet se: “1. Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive bëhet nga sekretari gjyqësor ose nën mbikqyrjen e tij nga teknikë të caktuar nga gjykata për këtë qëllim, duke treguar në mënyrë të saktë të gjithë përmbajtjen e regjistrimit. 2. Transkriptimi nënshkruhet nga sekretari gjyqësor dhe personi që e ka kryer atë. 3. **Transkriptimi i procesverbalit bëhet kur: a) kërkohet nga anëtarët e trupit gjykues; b) kërkohet me shkrim nga palët në gjykim dhe kjo kërkesë miratohet nga kryetari i trupit gjykues, pasi paguhen tarifat e vendosura për këtë qëllim, të përcaktuara me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë. Kur transkriptimi i procesverbalit kërkohet pas përfundimit të gjykimit, mbi kërkesën vendos kryetari i gjykatës.** 4. Transkriptimi i regjistrimit mund të bëhet për të gjitha seancat e një çështjeje, për seanca të veçanta ose për pjesë të shkëputura prej tyre, sipas kërkesës së palës që kërkon transkriptimin. Nëse kryhen gjatë gjykimit, materialet e transkriptimit i bashkëlidhen dosjes gjyqësore dhe janë pjesë përbërëse e saj.

Ndërkohë në nenin 6 pika 2 të K.Pr.Penale parashikohet se: “2. Mbrotjtësi ndihmon të pandehurin që ti garantohen të drejtat procedurale dhe ti ruhen interesat e tij ligjore.”

Paralelisht në datën 26 Dhjetor 2023 kemi paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtares Irena Gjoka. Na u bë me dije dhe vetëm verbalisht na u tregua që kjo kërkesë është gjykuar nga gjyqtarja Rudina Palloi dhe nga sa konstatuam në vendimin që na u tregua verbalisht ishte vetëm dispozitivi dhe jo vendimi i arsyetuar. Duke qënë se kanë kaluar 48 orë nga depozitimi dhe duke qënë se në përputhje me nenin 22 pika 3 KPrP ve detyron gjykatën pasi merr të dhënat e nevojshme vendos për kërkesën e përjashtimit brenda 48 orëve. Pra brenda 48 orëve duhet të na vihej në dispozicion Vendimi që ka konstatuar si të papranueshme kërkesën për përjashtim. Në këtë aspekt kërkojmë Vendimin e Arsyetuar, një kopje të dosjes ku përfshihet edhe mendimi i gjyqtares Irena

A handwritten signature in black ink is written over a rectangular stamp. The stamp contains the number '2' in the center. The signature is a cursive-style name, possibly 'Irena Gjoka', written over the stamp and extending to the right.

Gjoka, si dhe aktet administrative se si është caktuar gjyqtarja Rudina Palloi për gjykimin e kësaj kërkesë.

Duhet t'i bëjmë me dije gjykatës se të njëjtat shkelje janë konstatuar edhe për kërkesën për përjashtim gjatë gjyimit të verifikimit të kushteve të masave të sigurimit shtrënguese personale ndaj personit nën hetim Sali Berisha sipas procedurës së parashikuar nga neni 248 KPrP zhvilluar në datat 24, 25 dhe 26 Tetor 2023 ku gjatë atij gjykimi përsëri kërkuar përjashtimin e gjyqtarës dhe sërish ende sot megjithëse kanë kaluar dy muaj asnjëherë nuk na është vënë në dispozicion vendimi. Në këtë kuadër kërkojmë Vendimin që ka rrëzuar kërkesën tonë të arsyetuar, një kopje të dosjes ku përfshihet edhe mendimi i gjyqtarës Irena Gjoka, si dhe aktet administrative se si është caktuar gjyqtarja Rudina Palloi për gjykimin e kësaj kërkesë.

Bazuar në nenet 6 pika 2, 115 e 116 të K.Pr.Penale, Ju kërkojmë të na pajisni me:

- Kopje të procesverbalit dhe audios dhe të transkripteve të seancave të datave 26 Dhjetor 2023 ora 10:00 dhe 27 Dhjetor 2023 ora 11:00;
- Vendimin e Arsyetuar për papranueshmërinë e kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës Irena Gjoka depozituar nga ana jonë në datën 26 Dhjetor 2023, një kopje të dosjes ku përfshihet edhe mendimi i gjyqtarës Irena Gjoka, si dhe aktet administrative se si është caktuar gjyqtarja Rudina Palloi për gjykimin e kësaj kërkesë;
- Vendimin e Arsyetuar për papranueshmërinë e kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës Irena Gjoka bërë në seancën e datës 24 Tetor 2023 dhe depozituar nga ana jonë në datën 25 Tetor 2023, një kopje të dosjes ku përfshihet edhe mendimi i gjyqtarës Irena Gjoka, si dhe aktet administrative se si është caktuar gjyqtarja Rudina Palloi për gjykimin e kësaj kërkesë.

Kërkues:

Sali BERISHA

Av. Sokol MËNGJESI

Nr cel
0692618941

Sokol Mengjesi
